

VENDIM
Nr.784, datë 26.11.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KROACISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE TË MJEKËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë dhe të mjekësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KROACISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE MJEKËSISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (këtej e tutje të quajtura "Palë Kontraktuese"), me qëllimin e promovimit të bashkëpunimit midis dy vendeve respektive në fushën e mjekësisë dhe shkencave mjekësore, kanë rënë dakord për Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e mjekësisë dhe shkencave mjekësore mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit të përbashkët. Fushat specifike të bashkëpunimit do të caktohen sipas interesit të përbashkët, duke pasur parasysh interesin respektiv të Palëve Kontraktuese.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të ndihmojnë veçanërisht në:

- këmbimin e informacionit në fushën e shëndetësisë, referuar veçanërisht shëndetit publik, promovimit shëndetësor dhe parandalimit të sëmundjeve dhe organizimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- këmbimin e specialistëve për qëllime studimi dhe konsultimesh mbi bazën e planit të bashkëpunimit, të nënshkruar në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje;
- kontaktet direkte midis institucioneve dhe organizatave në vendet përkatëse;
- forma të tjera bashkëpunimi në fushën e mjekësisë për të cilat është rënë dakord.

Neni 3

Palët Kontraktuese do të këmbëjnë informacione në kongrese dhe simpoziume me pjesëmarrje ndërkombëtare, që do të organizohen në vendet respektive në fushën e shëndetit dhe të mjekësisë. Sipas kërkesës së njërës nga Palët Kontraktuese, Pala tjetër do të furnizojë me materialet e duhura lidhur me këto aktivitete.

Neni 4

Organizmat respektive të Palëve Kontraktuese do të këmbëjnë lista të literaturës mjekësore dhe filma mbi promovimin mjekësor, si dhe materiale të tjera informative të shkruara, vizuale ose audio-vizuale në fushën e studimeve shëndetësore.

Neni 5

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të përgatisin periodikisht plane bashkëpunimi ndërmjet Ministrive të tyre të Shëndetësisë, ku do të specifikohet bashkëpunimi për periudhën përkatëse dhe do të përcaktohen kushtet financiare për zbatimin e tyre.

Neni 6

Të gjitha këmbimet, si dhe forma të tjera bashkëpunimi që do të rezultojnë nga kjo Marrëveshje, do të zbatohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të së cilës, Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë pesë (5) vjeçare, që nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të tjera pesë (5) vjeçare, nëse asnjë nga Palët Kontraktuese nuk jep njoftim me shkrim 6 muaj më përpara.

Bërë në Tiranë, më 27 tetor 2003, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, të dyja autentike. Në rast divergjence në interpretim, për bazë do të merret teksti anglisht.